



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 285 , datë 20.05.2013

“Për

shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA për revokimin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë””

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAIMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.05.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania SHA” për revokimin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë” të Komisionit të Konkurrencës”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d, dhe neni 46 .

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania SHA” për revokimin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë””.

Relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës për këtë kërkesë.

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës ka marrë në shqyrtim kërkesën e ndërmarrjes Vodafon Albania SHA për revokimin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë” të Komisionit të Konkurrencës”.

Revokimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, mund të bëhet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në nenin 46 të Ligjit për mbrojtjen e

konkurrencës. Sipas këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:

- a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
- b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
- c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes Vodafone dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve të sipërcituara. Pra, në kuptim të nenit 46 të Ligjit 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes Vodafone nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, dhe nenin 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.
2. Mospranimin e kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA për revokimin Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “Vodafone Albania” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS			
Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar
			Lindita MILO(LATI)

KRYETAR

